



QPKMR

*Qendra e Parandalimit Të Krimeve
Të Të Miturve Dhe Të Rinjve*



IPO
INTERNATIONAL POLICE ORGANIZATION
www.interpolice.org

Tiranë, më 29.08.2022

QPKMR. Nr. 202 prot.

IPO HQ. Nr. 01/HQ prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

QËNDRËS PËR PARANDALIMIN E KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE
QPKMR

DHE

INTERNATIONAL POLICE ORGANIZATION IPO

Marrëveshje e cila lidhet për implementimin e qasjeve të trajnimeve dhe teknikave për zbatimin e drejtësisë miqësore për të miturit dhe te rintjtë në konflikt me ligjin.

Marrëveshja përfshin disa pikë me temat dhe problematikat kryesore si më poshtë:

- Ngritjen e nivelit të përfshirjes së të rinxve në jetën shoqërore, sociale dhe kulturore, zhvillimin dhe integrimin e tyre në jetën profesionale dhe ekonomike nëpermjet programeve të edukimit dhe riedukimit civil, shoqëror dhe professional si mjet për parandalimin e krimit dhe ricidivizmit duke zbatuar aktivitete dhe iniciativa të programuara të drejtësisë miqësore dhe restauruese për të miturit dhe të rinxjtë në kontakt me ligjin dhe për zbatimin e tij duke u fokusuar në nevojat specifike dhe rrëthanat e tyre për të implementuar funksionimin e një sistemi ndryshe nga sistemi i drejtësisë për të rritur.
- Parandalimi i Recidivizmit dhe Riintegrimi Social të shkelësve të ligjit, duke pasur si qëllim zhvillimin e programeve të përshtatshme që i përgjigjen shqetësimëve të komunitetit, duke u mbështetur në pikat e forta të komunitetit dhe që lejojnë një komunitet të menaxhojë rreziqet ndaj të cilave mund të ekspozohet.

Roli i IPO-s është i rëndësishëm pasi bashkëpunimi me qytetarët dhe edukimi i tyre për menaxhimin e situatave kritike dhe emergjente, do të krijojë urën lidhëse mes forcave të rendit dhe civilëve duke krijuar akses në të dhënat për komunitetet në të cilat jetojnë shkelësit ose po planifikojnë të kthehen, duke përfshirë kapacitetin e tyre për të ofruar shërbime dhe mbikëqyrje.

- Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet fenomenit të përfshirjes së të miturve në krimin e organizuar, krijimit të programeve për mbështetjen dhe parandalimin e recidivizmit pikërisht në këto raste, pasi nga përvoja kemi kostuar se shumica e të miturve me shkelje të përsëritur janë të ndikuar ose përdorur nga banda apo grupime me persona më të rritur.
- Do të bashkëpunohet me Institucionet e tjera për të vlerësuar së bashku një program riintegrimi social, duke vlerësuar rëndësinë se; Policia, Administratat e Burgjeve, Agjencitë e Provës, Entet e tjera Qeveritare si Ministria e Arsimit, kryesisht Oficerët e Sigurisë në Shkolla dhe Organizatat me bazë në komunitet kanë të gjitha role të rëndësishme në trajtimin e përbashkët të disa prej sfidave që lidhen me zhvillimin, menaxhimin dhe vlerësimin e programeve të riintegrimit social.
- Bashkëpunimi efektiv mes këtyre agjencive, një vizion dhe përgjegjësi e përbashkët për parandalimin e recidivizmit janë thelbësore për të mundësuar një strategji gjithëpërfshirëse në fushën sociale në atë mënyrë që riintegrimi të jetë i suksesshëm dhe të rezultojë në përfitime të prekshme për sigurinë e komunitetit dhe të ardhmen e të miturve dhe të rinxve .
- Krijimin e një modeli të ofrimit të shërbimeve për “përkujdesje të plotë”, nga burgu në komunitet si dhe ofrimin e shërbimeve nëpërmjet partneriteteve të integruara.
- Në këtë drejtim, do të punojmë për të fuqizuar praktikisht **“QPKMR”** si një agjenci e vetme per të marrë rolin udhëheqës në partneritet dhe të jetë përgjegjëse për koordinimin e ndërhyrjes në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimit të të miturve dhe të rinxve në konflikt me ligjin, sipas legjislacionit në fuqi.

Një marrëveshje e tillë ka si qëllim të ndihmojë partnerët e ndryshëm dhe aktorë të tjera në zhvillimin e një vizioni të përbashkët për atë që duhet të arrihet si dhe një gjuhë të përbashkët në të cilën mund të komunikojnë më mirë me njëri-tjetrin për procesin dhe objektivat e programeve.

Sot më datë, ____ / ____ / _____, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërrnjet palëve:

INTERNATIONAL POLICE ORGANIZATION IPO, organizatë profesionale shumëkombëshe, joqeveritare dhe jo fitimprurëse që përmes edukimit dhe punës shkencore synon të krijojë mjete teorike dhe praktike duke shërbyer si një urë lidhëse midis komunitetit dhe zbatimit të ligjit duke bashkuar profesionistët civilë dhe strukturat e sigurisë me vizionin e ndërtimit të një shoqërie pa kërcënime krimi dhe synon të punojë ngushtë me ligjin, organet ekzekutive dhe përmbarimore duke ofruar asistencë teknike dhe profesionale në parandalimin e kriminalitetit, veprave penale, studimin dhe hulumtimin e autorëve, dokumentimin e veprimtarisë kriminale për sjelljen e të dyshuarve para drejtësisë, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit për parandalimin dhe luftimin e krimit të përgjithshëm dhe të organizuar nëpërmjet bashkëpunimit me Organizatat Kombëtare dhe Ndërkombëtare, joqeveritare dhe ndërqeveritare për zbatimin e programeve dhe projekteve të ndryshme duke kontribuar së bashku për një komunitet më të sigurt dhe një të nesërme më të sigurt.

Selia qëndrore Ndërkombëtare IPO HEADQUARTERS me adresë: Rr. Ferrante Aporti 28, 20125, Milano, Itali, me nr regjistrimi në organet kompetente Kod Fiskal 97882740158, përfaqësuar nga **Presidenti Ekzekutiv / Chief Executive Officer–CEO Dr. Mareglen Tomori**

dhe

“QËNDRA PËR PARANDALIMIN E KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE” institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, me adresë: Bulevardi Zogu I, Tiranë 1000, përfaqësuar nga **Znj.Klaudia Hasanllari, Drejtuese e QPKMR**

Duke qënë se Palët:

Vleresojnë rëndësinë e përmirësirnit të administrimit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmiresimit të respektimit të drejtave të njeriut.

Preamble:

Qëndra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve QPKMR, dhe International Police Organization IPO në vijim të quajtura palë me ankronomiet **QPKMR** dhe **IPO**:

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të administrimit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmiresimit të respektimit të të drejtave të njeriut;

Duke marrë në konsideratë masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin dhe kërkasat për implementimin e suksesshëm të tyre;

Duke synuar implementimin efektiv të ligjit **nr. 37/2017, datë 30.03.2017** " Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" nëpërmjet prezantimit të teknikave restauruese për të rinjtë në konflikt me ligjin, teknika inovative në konteksttin shqiptar;

Duke krijuar strategji për zbatimin e Konventës mbi të drejtat e fëmijës miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara OKB më 20 nëntor 1989;

Duke ofruar mbikëqyrje të rasteve konkrete përmes bashkëpunimit me policinë, shkollat, pushtetin vendor dhe siguruar zbatimin e Kodit të Procedurave Penale për të Miturit, nëpërmjet trajnimit të burimeve njerëzore të punonjësve të policisë së shtetit, institucioneve ne nivel qëndror dhe vendor;

Duke krijuar masa plan veprimi dhe edukimi për parandalim e recidivizmit nëpërmjet teknikave të reja të monitorimit;

Duke konsideruar se për të kontribuar në respektimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht të fëmijëve e të rinjve në konflikt ose në kontakt me ligjin është e domosdoshme nxitja e zbatimit të qasjeve restauruese të drejtësisë;

Duke konfirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje për të përbushur angazhimet e ndërmarra në kuadër të përmirësimit të drejtësisë penale për të mitur dhe të rinjtë;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim të quajtur Marrëveshje.

Neni 1

Qëllimi:

- Marrëveshja ka për qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e angazhimeve ndërmjet palëve:
- Përdorimi i ambjenteve të përbashkëta midis IPO-s dhe QPKMR, në QPKMR prane MD-së për të zhvilluar zbatimin e aktiviteteve që synojnë implementimin e qasjeve dhe të teknikave restauruese për të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin si dhe trajnimin e specialistëve të fushës së sistemit të drejtësisë, dhe punonjësve që punojnë për zbatimin e Kodit të Procedurës Penale për të Mitur me qëllim integrimin e të miturve dhe të rinjve për të pasur një pjesëmarrje aktive në proceset sociale, krijimin e mundësive dhe mbështetje të punësimit të të rinjve, edukimin për parandalimin e dukurive të dëmshme për të rinjtë, ndërgjegjësimin e tyre ndaj dukurive negative, duke identifikuar të rinjtë pasivë dhe duke përfshirë sa më shumë të rinj në aktivitete kundër dukurive ilegale dhe të dëmshme për shoqërinë.

Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërinstitucional Kombëtar dhe Ndërkombëtar përfshin një sërë objektivash specifike, si në vijim:

- 1). Realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit dhe parandalimin e krimeve të të miturve dhe të rinjve.
- 2). Bashkëpunimin me Shërbimin e Provës dhe me administratën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur në përgatitjen e dokumentit përlirim me kusht.
- 3). Përfshirjen e Ekspertëve të ndryshëm për parandalimin e krimtit, Psikologëve, Analistëve të Krimtit, Kriminologëve etj, në vlerësimin e rezikut familjar dhe shoqëror/mqedisor dhe të nevojave të të miturit jashtë strukturave të kryrjes së dënimit, ndjekjen, mbikëqyrjen dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike, arsimore, shëndetësore, profesionale dhe situatën ekonomiko/sociale të të miturit pas dënimit.

- 4). Bashkëpunimin me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës, sipas përcaktimeve të ligjit, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, për miratimin e planit të rehabilitimit dhe të rishoqërizimit të të miturit, koordinimin e masave që do të merren për zbatimin e planit të rehabilitimit dhe të rishoqërizimit si dhe mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit për rishoqërizimin e të miturit.
- 5). Studimi dhe Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, zhvillimi i hulumtimeve proaktive dhe reaktive, parandalimin e trafikimit me narkotik, trafikimit me qënie njerëzore, kontrabandim me migrant, trafikimin e armëve, dokumentacione false, krimet kibernetike, pedopornografinë, bulizmin kibernetik etj, me qëllim uljen e aktivizimit të të rinjve në këto aktivitete.
- 6). Studimi dhe Parandalimi i krimeve ekonomike, financiare dhe të korruptionit në institucionet të cilat kanë lidhje direkte apo indirekte me të miturit dhe të rinjtë.
- 7). Ngritja e efikasitetit dhe kualitetit në punën hetimore/mbikqyrëse dhe ndërhyrjes për parandalimin e kriminalitetit të punonjësve të strukturave Policore, Gjyqësore, Sociale dhe Arsimore, kryesisht “Oficerët e Sigurisë në Shkolla” nëpërmjet ofrimit të kurseve dhe programeve të trajnimeve profesionale.
- 8). Forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin në promovimin e modeleve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm tek të miturit dhe të rinjtë.
- 9). Krijimin dhe konsolidimin e aftësive të shoqërisë civile në komunikimin publik dhe edukimin qytetar, nxitjen e qytetarëve në veprimtari sociale, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre për zhvillimin e komunitetit në tërësi si faktor kryesor për uljen e kriminalitetit duke përfshire prindërit dhe familjarët.
- 10). Mbështetjen në hartimin e dispozitave ligjore dhe të protokolleve të punës për trajtimin e të miturve nën moshën e përgjegjësise penale dhe drejtësise restauuese.
- Inicimin dhe inkurajimin për aktivizimin e të rinjve në çështje të interesit të përbashkët në rang Kombëtar dhe Ndërkombëtar në cilësinë e Institucionit Këshillues lidhur me çështje dhe situata që kanë të bëjnë me rininë, avancimin dhe mbrojtjen e aktiviteteve, në dobi të të rinjve, avancimin e infrastrukturës rimore, organizimin dhe menaxhimin e fushatave dhe aktiviteteve për parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotikëve, alkoolit dhe duhanit, aktivizimin dhe organizimin e rinisë në jetën sociale si në sport, art, kulturë, shëndetësi, ekonomi, etj, po ashtu dhe restaurimin e profesioneve të lira për ndërtimin e karierës dhe tolerancës mes tyre.
- Ngritja e nivelit të përfshirjes së të rinjve në jetën shoqërore, sociale dhe kulturore, zhvillimin dhe Integrin e tyre në jetën profesionale dhe ekonomike, përmes vullnetarizmit, rekreacionit, organizimit, performancës dhe realizimit të aktiviteteve të ndryshme, krijimin e mundesisë për ngritjen dhe menaxhimin e Qëndrave Sociale Multifunksionale për Rininë.
- Qasja analitike e të dhënavë, definimin e problemeve, objektivave, masave që duhet të ndërmerren si dhe rekomandimin për parandalim dhe zgjidhjen e problematikave të caktuara.
- ❖ Në përputhje me programet dhe objektivat e IPO-s, duke u bazuar në politikat ndër-sektoriale dhe specifike, ku në qëllimet kryesore dhe me prioritet të lartë janë :

➤ **PJESËMARRJA E RINISË**

Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe përfshirja sa më e madhe e të rinjve në politikë-bërje sektoriale që ndikojnë drejtpërdrejt te të rinjtë.

➤ SPORTI, KULTURA DHE REKREACIONI

Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore, sociale, ekonomike dhe kulturore përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

➤ EDUKIMI JO-FORMAL

Të rinj të edukuar dhe të përgatitur për të përballuar të gjitha sfidat e jetës si anëtarë të përgjegjshëm të komunitetit vendor dhe evropian.

➤ PUNËSIMI DHE NDËRMARRËSIA

Nxitja e punësimit përmes programeve, trajnimeve profesionale dhe mbështetjes së të rinjë duke bashkëpunuar me institucione dhe sipërmarrës për punësimin e tyre.

➤ SHËNDETI, EDUKIMI DHE PROMOVIMI SHËNDETËSOR

Të rinj të vetëdijësuar lidhur me rëndësinë e ruajtjes së shëndetit për mirëqenien e tyre individuale dhe shoqërore, si dhe për kontributin e tyre si qytetar të përgjegjshëm të vendit.

➤ SIGURIA NJERËZORE

Të rinj të përgatitur për të identifikuar, parandaluar dhe adresuar në kohë dhe në mënyrë efektive rrezikun që u kanoset të rinjve si dhe të asistojnë bashkëmoshatarët e tyre në uljen e kriminalitetit.

Neni 2

Objekti:

Palët, në përputhje me prioritetet e veprimtarisë së tyre bien dakord te bashkëpunojnë:

- 1.) Për vënien në zbatim të NENIT nr. 1 të kësaj Marrëveshje dhe të aktiviteve dhe iniciativave të programuara të drejtësisë restauruese për të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin.
- 2.) Për forcimin e drejtësisë miqësore për të miturit dhë të rinjtë në konflikt me ligjin me fokus të posaçëm rehabilitimin dhe parandalimin e recidivizmit dhe zbatimin efektiv të detyrimeve të parashikuara në masën e shambahs nga ndjekja penale përfshirjen në programet të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetesimit.
- 3.) Për forcimin e kapaciteteve të profesionisteve të drejtësisë për të mitur të fushës sociale psikologjike dhe kriminologjike, në teknikat e sjelljes dhe veprimeve me të rinjtë dhe me të miturit mbi dhe nën moshën përgjegjesi penale ose në rrezik të përfshirjes në veprimtari të dëmshme, me synimin e promovimit dhe garantimit të qasjeve restauruese.
- 4.) Për hartimin e studimeve, analizave, protokolleve zbatuese dhe akteve të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e mekanizmave të mbrojtjes së sistemit të drejtësisë restauruese.

Neni 3

Detyrimet e Palëve:

Secila nga palët sipas fushës së veprimtarisë së tyre kanë detyrimet e mëposhtme:

QPKMR:

- a) Koordinon dhe lehtëson bashkëpunimin me institucionet e varësisë për zbatimin e aktiviteteve të drejtësisë restauruese si dhe me intitucionet e tjera përkatëse: Ministria e Brendshme “Policia”, Ministria e Arsimit “Oficerët e Sigurisë në Shkolla” si dhe cdo institucion tjetër relativ në realizimin e objektivave të kësaj marrëveshje.
- b) Nxit dhe mbështet bashkëpunimin e IPO-s me institucionet kompetente në hartimin e kurrikulave dhe zhvillimin e trajnimeve me qëllim përfshirjen në programet e tyre të tematikeve që lidhen me drejtësinë restauruese.
- c) Përfshin në grupet e punës dhe në rrjetin ndërinstitucional të punës për drejtësinë për të mitur përfaqësues të IPO-s.

IPO:

- a) Ofron mbështetje teknike dhe profesionale për zbatimin me sukses të objektivave dhe aktiviteteve të rëna dakort në këtë Marrëveshje Bashkepunimi.
- b) Krijon mundesine për gjetjen e sponsorizimeve për realizimin e projekteve që do të zhvillohen me angazhimin e të dyja palëve.
- c) Vë në disposicion materialet burimore, module trajnimi, staf me ekspertizë për hartimin e metodologjisë dhe mjeteve të punës për arritjen e objektivave që ka marrëveshja.
- d) Mundëson ofrimin e ekspertizës nga partnerët e saj vendas dhe konsulencën e huaj në hartimin e praktikave, protokolleve dhe skemave për zbatimin e qasjeve restauruese.
- e) Mundëson ofrimin e asistencës për hartimin e kurrikulave dhe zhvillimin e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të profesionisteve të drejtësisë penale për të miturit dhe të rinjt për programet e drejtësisë restauruese.

Neni 4

Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes:

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht funksionimin e bashkëpunimit në mbështetje të marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së raporteve periodike, çdo 6 muaj, me shkrim pranë titullarëve të palëve.
2. Raporti periodik përban, krahas të dhenave për mënyrën e zbatimit të Marrëveshjes, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 5

Komunikimi mes Palëve:

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërrnjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përbushjen e detyrate të tyre.
-Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe në raste të veçanta edhe në rrugë elektronike.
2. Palët do të caktojnë personat e kontaktit që do të janë përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e kërkesave të tyre në zbatim të Marrëveshjes.
3. Personat e kontaktit nga të dyja palët do të janë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me qellim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërrneren rast pas rasti.

Neni 6

Kohezgjatja e Marrëveshjes:

Kjo Marrëveshje zbatohet pa afat të caktuar dhe qëndron në fuqi deri në një komunikim zyrtar mes palëve për ndërprerjen e saj.

Neni 7

Ndryshimi i Marrëveshjes:

Kjo Marrëveshje mund të ndryshojë vetëm me dakordësim të palëve nëpermjet shkëmbirnit të komunikimit me shkrim duke percaktuar motivacionin e ndryshimit.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me mirekuptim mes palëve.

Neni 9

Kostot financiare:

Kostot financiare të aktiviteteve që do të kryhen në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes do të mbulohen nga të dyja palët.

Në rastet kur do të ketë financime apo donacione nga faktor të jashtëm për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve dhe projekteve, palët do të bien dakord dhe do të nënshkruajnë një aneks marrëveshje ku do të përcaktohet mënyra e menaxhimit të financave dhe çdo detaj tjetër i nevojshëm.

Neni 10

Hyrja në fuqi e marrëveshjes:

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrirnit

Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej te cilave depozitohen ne Ministrinë e Drejtësisë, një në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën angleze.


Nënshkruar në Tirane, më _____._____._____

NË EMËR TË

**QËNDRA PËR PARANDALIMIN E KRIMEVE
TË TË MITURVE DHE TË RINJE
QPKMR**

DREJTUESE E QËNDRËS


Znj. Klaudia Hasanllari



**INTERNATIONAL
POLICE ORGANIZATION
IPO**

PRESIDENTI EKZEKUTIV

Dr. Mareglen Tomori



QPKMR

*Qendra e Parandalimit Te Krimeve
Te Te Miturve Dhe Te Rinje*



**IPO
INTERNATIONAL
POLICE
ORGANIZATION**
www.interpolate.org